



1

Detaje nga krimi makabër kundër çiftit Pasho, hetuesit: Nusja, Elona nuk veproi e vetme! Krimi dyshohet për 'thesarin' e çiftit

2

Trendi në ulje i rasteve ditore/ Brataj në Report Tv: Është ulur kërkesa për të bërë tampon! Më pak të shtruar edhe nga publiciteti i keq që i kanë bërë spitaleve

3

Shkodër/ Të shtëna me armë zjarri pranë një lokali

4

Vrasja dhe masakrimi i trupave të çiftit Pasho në Itali/ Del video, ky është momenti i arrestimit të nuses

5

Kërkon t'i jap fund martesës, babai nuk e lejon/ Zhdukët 35-vjeçarja 'Pa Gjurmë' i mundëson të flasin me të bijën live në program (VIDEO)

Aktualitet

Kishin dalë për gjueti, 18 vjeçari vret pa dashje shokun me armë gjahu në Maqellarë! Shkak mendohet të ketë qenë mjegulla! Kapet autori

Një ngjarje e rëndë ka ndodhur sot në Dibër, ku një 27 vjeçar vdekur pasi është plagosur me armë gjahu çifte nga shoku i tij.

■ Del fotoja e 18 vjeçarit që vrau pa dashje shokun



Një ngjarje e rëndë ka ndodhur sot në Maqellarë, ku një 27 vjeçar ka vdekur pasi është qëlluar me armë gjahu çifte nga shoku i tij teksa kishin dalë për gjueti.

Rreth orës 14:45, në vendin e quajtur “Malet e Obokut”, Rifat Xheleshi 18 vjeç dhe Gentian Kosiqi (viktima) 27 vjeç, kishin dalë për gjueti. Xheleshi, dyshohet se nga pakujdesia ka plagosur me armë gjahu çifte shokun e tij Gentian Kosiqi, banues në Maqellarë. Si pasojë e plagëve të marra 27 vjeçari ka humbur jetën në spital.

[Sh.com]

LEXO EDHE:

Vrau shokun aksidentalisht në gjueti, arrestohet 18-vjeçari në Dibër! Nën hetim një tjetër person që ishte në vendngjarje

Shkaku mendohet të ketë qenë mjegulla e dendur e cila u ka kufizuar shikimin. Ka qenë një shok tjetër i cili bashkë me autorin kanë marrë shokun e plagosur dhe e kanë nisur për në spital, por ai fatkeqësisht nuk ka mbijetuar prej plagës që ka marrë.

Menjëherë më pas autori është vënë në pranga dhe policia po e merr në pyetje për të zbardhur ngjarjen e plotë, e cila ka qenë aksidentale. Në cilësinë e provës materiale është sekuestruar arma e gjahut çifte, me të cilën është qëlluar viktima.

Ndërkohë kujtojmë se një rast i ngjashëm ka ndodhur **më 26 nëntor** në qytetin e Bulqizës, ku mbeti i vrarë Elidon Basha, 22-vjeç, teksa kishte dalë për gjueti me mikun e tij. Ajo që nisi si gjueti mes dy të rinjve, Klodian Kolës dhe Elidon Bashës përfundoi në vrasjen e këtij të fundit me anë të një kallashnikov.

Njoftimi i policisë:

Dyshohet se nga pakujdesia plagosi me pasojë vdekjen shokun e tij, Policia shoqëron në Komisariat autorin e dyshuar. Sekuestrohet arma e gjahut çifte. Rreth orës 14:45, në vendin e quajtur “Malet e Obokut”, Maqellarë, shtetasi R. XH. dhe G. K. kanë qenë për gjueti. Shtetasi R. XH., 18 vjeç dyshohet se nga pakujdesia ka plagosur me armë gjahu çifte shtetasin G. K., rreth 27 vjeç, banues në Maqellarë, i cili ka humbur jetën në spital.

Menjëherë shërbimet e Policisë dhe grupi hetimor kanë shkuar në vendngjarje dhe kanë bërë shoqërimin e autorit të dyshuar në Komisariat, për veprime të mëtejshme hetimore, si dhe kanë sekuestruar në cilësinë e provës materiale armën e gjahut çifte.

Rifat Xheleshi dhe viktima Gentjan Kosiqi

Rendit zhvillimet sipas orarit:

Të Fundit

Ora 18:03

Vrau shokun pa dashje me armë gjahu në Maqellarë, del fotoja e 18 vjeçarit

Ky është 18 vjeçari Rifat Xheleshi i cili sot ka vrarë pa dashje me armë gjahu teksa kishin dalë për gjueti, shokun e tij Gentian Kosiqi 27 vjeç.

Ora 17:55

Detaje nga vrasja e 27 vjeçarit në Dibër nga shoku, shkak mendohet të ketë qenë mjegulla

Rreth orës 14:45 në malet sipër fshatit Hobok është plagosur për vdekje shtetasi Gentjan Kosiqi.

Sipas informacioneve të policisë kanë qenë për gjueti viktima Gentjan Kosiqi dhe shoku i tij Rifat Xheleshi, ky i fundit dyshohet ta ketë qëlluar aksidentalisht shokun e tij. Shkaku mendohet të ketë qenë mjegulla e dendur e cila u ka kufizuar shikimin. Ka qenë shoku tjetër i cili bashkë me autorin kanë marrë shokun e plagosur dhe e kanë nisur për në spital.

Be.K./Shqiptarja.com

TAG:

vrasje

diber

arme gjahu

maqellare

Rifat Xheleshi

Gentian Kosiqi

Ndalohet repretësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH.com

Sondazhi i ditës:

A mendoni se mbyllja që në 20:30 është masa e duhur për të frenuar përhapjen e COVID-19 gjatë festave?

PO

JO

NUK E DI

Komento

Komente

Nnccnxxn:

17/12/2020 18:37

E cna duhet një foto e personit qe ju vidhi neper rrjete sociale "media" vemje?!

Përgjigju

Lajme të tjera

Aktualitet

Covid-19, sa rezultat vireni i ri?

Brataj: Është ulur koha e qëndrimit në spital! Nga 14 ditë është bërë rreth 8 ditë! Arsyet

22 Dhjetor, 21:27

Aktualitet

Covid-19, sa rezultat vireni i ri?

Trendi në ulje i rasteve ditore/ Brataj në Report Tv: Është ulur kërkesa për të bërë tampon! Më pak të shtruar edhe nga publiciteti i keq që i kanë bërë spitaleve

22 Dhjetor, 21:15

Aktualitet

Aksident në aksin Rrogozhinë-Lushnje, makina del nga rruga dhe përfundon në oborrin e një shtëpie! Plagosen dy persona (VIDEO)

22 Dhjetor, 21:13

Aktualitet

Liroi nga krimi të dënuarit e përjetshëm, KLGJ vendos nesër për seancën e marrjes në pyetje të Enkeleida Hoxhës

22 Dhjetor, 20:02

Aktualitet

Detaje nga krimi makabër kundër çiftit Pasho, hetuesit: Nusja, Elona nuk veproi e vetme! Krimi dyshohet për 'thesarin' e çiftit

22 Dhjetor, 19:47

Aktualitet

Vrasja dhe masakrimi i trupave të çiftit Pasho në Itali/ Del video, ky është momenti i arrestimit të nuses

22 Dhjetor, 19:32

Kodi Etik

Kontakt

Rreth Nesh

Raportoni Ju

[Shqiptarja.com]

f

t

u

o

g

Kërko

© 2011 - 2020 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje